



Udhërrëfytyesi për Integrimin e Romëve 2019-2021 për Shqipërinë





Integrimi i Romëve 2020 bashkëfinancohet nga



**OPEN SOCIETY
FOUNDATIONS**

Punësimi



Sipas Studimit Rajonal për Romët të UNDP-së të vitit 2017, niveli i punësimit të romëve në Shqipëri është 18%, krahasuar me nivelin e punësimit të fqinjëve të tyre jo romë, të cilët janë të punësuar në nivelin 27%. Sipas studimit, niveli i përgjithshëm i punësimit në Shqipëri është 56%. Raporti i bazuar në të njëjtën studim tregon më tej se 62% e romëve janë të angazhuar në punë joformale, ndërsa vetëm 23% e jo romëve që jetojnë në afërsi të tyre merren me një punë të tillë. Për rrjedhojë, hendeku në punët joformale është 39%. Një studim tjetër i UNDP-së [Skicimi i Aftësive, Mundësive për Punësim dhe Sipërmarrje nga Komunitetet Rome dhe Egjiptiane](#) i kryera në Tiranë, Durrës, Berat dhe Shkodër, tregon se romët merren kryesisht me grumbullimin e mbetjeve (grumbullimin e materialeve të riciklueshme) tregtitë e vogla në treg të hapur, ose në rrugë, shërbimet e pastrimit (gratë), punojnë në ndërtim si punëtorë të pakualifikuar dhe në prodhim (rrobaqepësi, këpucë, etj.). I njëjti studim tregon se romët janë kryesisht të përjashtuar nga skemat e ndihmës sociale (ndihma ekonomike, sigurimet shëndetësor, pensionet, etj.). Kjo çështje njihet edhe në [Programin e Reformës Ekonomike \(ERP\) 2019-2020](#).

Për të nxitur përfshirjen sociale të romëve në fushën e punësimit, objektivi që mund të vendoset për rritjen e shkallës së punësimit të romëve është të paktën 35% deri në kohën kur Shqipëria të bëhet pjesë e Bashkimit Evropian (BE). Supozohet që me rritjen e shkallës së punësimit të romëve, rritja e nivelit të punësimit midis fqinjëve të tyre jo romë do të ndjekë të paktën të njëjtin nivel. Sipas informacionit të paraqitur më sipër, mënyra më efektive për të nxitur punësimin e romëve do të jetë përmes formalizimit të punës së tyre të padeklaruar. Për të arritur nivelin e dëshiruar të punësimit, të paktën 23% e punës së padeklaruar midis romëve duhet të transformohet në punë të deklaruar deri në kohën e pranimit në BE. Në mënyrë që të ulët niveli i punës së padeklaruar ndërmjet romëve në 38%, kërkohet ulja graduale në 56% në vitin 2021 dhe në 48% në vitin 2025. Duke supozuar se niveli i punës së padeklaruar midis jo romëve mbetet i qëndrueshëm, hendeku i padeklaruar i punës në Shqipëri do të ulët në mënyrë efektive vetëm me 15%. Duke arritur këto objektiva, Shqipëria do të krijojë një tendencë të qëndrueshme për uljen e hendekut të punësimit midis romëve dhe jo romëve.

[Strategjia Kombëtare e Integritit të Romëve](#) (SKIR) përcakton masat e mëposhtme për të mbështetur punësimin e romëve: vendosjen e kuotave për romët në programet e nxitjes së punësimit; vlerësimin e ndikimit të mundshëm të përjashtimeve tatimore për romët që kalojnë në tregun e punës nga papunësia afatgjatë, mirëqenia sociale, lypja dhe puna informale; kryerjen e një studimi mbi pozitën e grumbulluesve individualë romë të mbetjeve të riciklueshme në kontekstin e dhënies së tyre me koncesion në zonat e vend-depozitimeve. [Përfundimet operationale](#) përcaktojnë nevojën për të përshtatur programet kryesore të promovimit të punësimit, në mënyrë që të sigurohet mbështetje shtesë për Romët dhe të zhvillohet një paketë specifike për të mbështetur mbledhësit individualë të materialeve të riciklimit (mbledhësit e mbetjeve). Deri tani nuk janë prezantuar kuota të programeve të promovimit të punësimit dhe paketa specifike të mbështetjes. Lidhur me mbështetjen për mbledhësit individualë të mbetjeve, në Bashkinë e Tiranës është zbatuar një program pilot i përkohshëm, në bashkëpunim me kompaninë private të angazhuara në biznesin e riciklimit.

Për të lehtësuar nxitjen e punësimit të romëve, duhet të prezantohen objektiva specifike për integrimin e romëve (që përkojnë me objektivat e përgjithshëm) në strategjitë kryesore të punësimit, planet e veprimit dhe dokumentet e tjera të politikave që lidhen me punësimin. Duhet të merren parasysh edhe prezantimi i kuotave për pjesëmarrjen e romëve në programet e nxitjes së punësimit dhe zhvillimi i një pakete mbështetëse shtesë për romët që marrin pjesë në programet kryesore të punësimit për të trajtuar situatën e tyre specifike.

¹Anketa Rajonale e Komisionit Evropian, Programit të Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara dhe Bankës Botërore e vitit 2017 – Dokument faktik për vendin, mund ta gjeni në adresën: http://www.eurasia.undp.org/content/dam/rbec/docs/Factsheet_ALBANIA_Roma.pdf

²Në përputhje me terminologjinë e institucioneve evropiane dhe organizatave ndërkombëtare, termi "romë" përdoret këtu për t'iu referuar disa grupeve të ndryshme (p.sh. romë, sinti, kale, xhipsi, romanishel, bojash, ashkali, egjiptianë, jenish, dom, lom, romë dhe abdalë) dhe përfshin edhe "udhëtarët" ose "itinerantët", pa mohuar veçoritë e këtyre grupeve).

³Kjo është në përputhje me aspiratat e Shqipërisë për promovimin e integritit të romëve siç pranohet në Deklaratën e Ballkanit Perëndimor për Romët dhe Zgjerimin e BE-së. Deklarata do të nënshkruhet në Samitin e Ballkanit Perëndimor në vitin 2019 në Poznan.

Projekti për integrimin e romëve do të punojë me qeverinë për të zhvilluar një program gjithëpërfshirës për formalizimin e punës së padeklaruar të mbledhësve individualë. Pa dyshim, mbledhja individuale e mbetjeve i përket punës së padeklaruar, pasi profesioni nuk është i standardizuar.

Projekti për integrimin e romëve do të ofrojë mbështetje për grumbullimin e të dhënave dhe vlerësimin e ndikimit të formalizimit të punës së grumbulluesve individualë të mbetjeve, standardizimin e profesionit, përgatitjen e legjislacionit parësor dhe dytësor shoqëruar dhe përgatitjen e propozimeve për financimin e zbatimit të programit.

Programi do të shtrihet në nivelin vendor në bashkëpunim me bashkitë me pjesëmarrjen më të madhe të popullsisë rome. Përvojat ekzistuese nga programi pilot i Tiranës do të integrohen në programin e ri.

Disa nga aspektet kryesore për zhvillimin e një programi gjithëpërfshirës të formalizimit të mosdeklarimit lidhen me: nevojën për të siguruar që romët të cilët e formalizojnë më mirë punën përfitojnë nga skemat ekzistuese të ndihmës sociale (të ndara përmes Fondit Social), si edhe nga trajtimi tatar preferencial deri sa ata të dalin në mënyrë të qëndrueshme nga varfëria; shqyrtimin e modaliteteve më të mira të mundshme për organizimin e formalizimit të punës së padeklaruar (duke përfshirë edhe organizimin e mundshëm të punës përmes ndërmarrjeve sociale); nevojën për integrimin e mbledhësve individualë të mbetjeve në legjislacionin e integruar të menaxhimit të mbetjeve (edhe në nivelin vendor) dhe mekanizma të mundshëm financimi për zbatimin e një programi formalizimi. Programi duhet të shqyrtojë po ashtu nevojat për trajnim për profesione të standardizuara dhe nevojën për trajtimin specifik të kësaj pune për shkak të natyrës së saj specifike (kontributi ndaj mbrojtjes mjedisore dhe kërkesave të sigurisë në punë).


Qeveria e Shqipërisë kërkon të zhvillojë një qasje ndërdisiplinore gjithëpërfshirëse, e cila promovon një integrim të romëve, i cili merr parasysh tërësinë e situatës social-ekonomike të përfituesve të synuar dhe ofron një paketë gjithëpërfshirëse integrimi që i përshtatet nevojave të tyre. Qasja gjithëpërfshirëse do të jetë në gjendje të sigurojë integrim të plotë dhe të qëndrueshëm të të gjithë përfituesve. **Shtylla kurrizore e qasjes gjithëpërfshirëse është integrimi i punësimit me mbështetjen për strehim, duke qenë që këto janë dy çështje parësore të ndërlidhura të cilat duhet të zgjidhen.** Pa punësim dhe të ardhura të qëndrueshme, një familje e ka të pamundur të mbajë veten. Kjo ka ndikim po ashtu edhe mbi qëndrueshmërinë e strehimit, pasi familjet pa të ardhura e kanë të pamundur t'i mbulojnë kostot e mirëmbajtjes së shtëpive dhe faturat e shërbimeve. Si pikë nisëse drejt zhvillimit të një qasje gjithëpërfshirëse, **projekti i integrit të romëve do ta mbështesë qeverinë shqiptare për të formuluar metodologjinë e qasjes së integruar, e cila si minimum lidh punësimin me mbështetjen për strehim, por mund të përfshijë po ashtu edhe fusha të tjera mbështetjeje. Projekti për integrimin e romëve do të japë përvojën e nevojshme për të konceptualizuar qasjen e integruar, duke përafuar edhe legjislacionin, kur kjo është e nevojshme, dhe për të zhvilluar një metodologji zbatimi.** Qasja integrale përfshin përfitimin e punësimit dhe trajnimeve nga romët, ndërkohë që synohet mbështetja për strehim. Në të njëjtën mënyrë, njerëzit që përfitojnë nga mbështetja për strehim duhet të përfshihen në planifikimin dhe zbatimin e kësaj initiative, duhe siguruar kështu trajnimin dhe punësimin e romëve përmes programeve të strehimit.

Gjatë vitit 2016, UNDP-ja dhe qeveria shqiptare realizuan hartëzimin e vendbanimeve rome në 18 bashki. Raportet e hartuara përshkruajnë situatën e strehimit në vendbanimet rome dhe identifikojnë nevojat për investim për rindërtimin e shtëpive dhe ofrimin e strehimit social. Informacioni nga raportet tregon se numërohen 7,289 familje rome që kanë nevojë për strehim të standardeve të përshtatshme. Informacioni aktual i dhënë nga qeveria e Shqipërisë thekson se 6,421 familje rome kanë nevojë për strehim të standardeve të përshtatshme, çfarë do të thotë se është zgjidhur problemi i strehimit për rreth 430 familje në vit. Duke marrë parasysh këtë dinamikë, **gurët kilometrikë janë ulja e numrit të familjeve rome në nevojë për strehim të përshtatshëm në përkatësisht 5500 deri në vitin 2021 dhe në 3500 në vitin 2025.** Numri i familjeve rome në nevojë për strehim të përshtatshëm do të ulet në 500 në kohën e pranimit në BE.

During 2016, the UNDP and the Government of Albania performed mapping of Roma settlements in 18 Albanian municipalities. The prepared reports⁴ describe the housing situation in Roma settlements and identify investment needs for housing reconstruction and the provision of social housing. Information from the reports shows that 7,289 Roma families were in need of housing of adequate standard. Current information provided by the Government of Albania point that 6,421 Roma families remain in need of housing of adequate standard, which indicates that housing problem was being resolved for about 430 households per year. Taking this dynamics into account, **the milestones are to gradually reduce the number of Roma households in need of adequate housing to 5500 in 2021 and 3500 in 2025 respectively.** The number of Roma households in need of adequate housing will be reduced to 500 at the time of EU accession.

⁴ Reporti "Vlerësimi i nevojave për investime në vendbanimet e komuniteteve rome dhe egjiptiane në Bashkitë Tiranë, Durrës, Krujë, Lezhë dhe Shkodër", mund ta gjeni në adresën: http://www.al.undp.org/content/albania/en/home/library/poverty/studimi_vleresimi-i-nevojave-per-investimeme-ne-vendbanimet-e-kom/; raporti " Vlerësimi i nevojave për investime në vendbanimet e komuniteteve rome dhe egjiptiane në Bashkitë Lushnje, Divjakë, Fier, Berat, Kucovë, Vlorë, Gjirokastrë, dhe Delvinë", të cilin mund ta gjeni në adresën: http://www.al.undp.org/content/albania/en/home/library/poverty/_vleresimi-i-nevojave-per-investime-ne-vendbanimet-e-komuniteteve0/; dhe raporti "Vlerësimi i nevojave për investime në vendbanimet e komuniteteve rome dhe egjiptiane në Bashkitë Elbasan, Pogradec, Maliq, Korçë dhe Devoll".

Strehimi



Shumë romë jetojnë në vendbanime të izoluar në zonat urbane dhe rurale, me 52% të familjeve pa akses në rrjetet e ujësjellësit dhe 37% pa akses në kanalizimet e ujërave të zeza të asnjë lloj forme (Studimi Rajonal për Romët i UNDP-së i vitit 2017).

Në të njëjtën kohë, Studimi tregon se 93% e romëve përballen me mungesa të rënda materiale. Faktorët e shumtë negativë të shpjeguar dëshmojnë nevojën e ofrimit të mbështetjes specifike për romët, duke e trajtuar çështjen e strehimit dhe të varfërisë në aspektin shumëdimensional.

Duke e njohur këtë nevojë, legalizimi i shtëpive dhe vendbanimeve informale të romëve duhet të përcaktohet si përparësi që në fazën e parë të zgjidhjes së problemit të strehimit të romëve. Për të trajtuar çështjen e varfërisë, vëmendje e veçantë do t'i kushtohet zhvillimit të një qasjeje integrale, e cila do të kombinojë strehimin me mbështetjen e punësimit, siç u shpjegua më sipër.

SKIR-ja e Shqipërisë parashikon masat e mëposhtme në mbështetje të strehimit të romëve dhe në veçanti në legjislacionin e strehimit: ofrimin e ndihmës juridike falas për romët që aplikojnë për legalizim; integrimin e familjeve rome përmes projekteve pilote për urbanizimin dhe integrimin e vendbanimeve informale të romëve; trajnimin e njësisve të qeverisjes vendore për përgatitjen e propozimeve narrative dhe financiare për projektet e strehimit që parandalojnë segregimin e romëve. Deri tani nuk janë kryer aktivitete për të mbështetur legalizimin e banesave në pronësi të romëve dhe nuk ka të dhëna për numrin e aplikimeve për legalizim nga ana e romëve dhe se sa përqind e tyre kanë qenë të suksesshme. Për momentin, afati i legalizimit ka kaluar. Ligji “Për strehimin social” u miratua në vitin 2018. Ligji garanton që romët do të përfitojnë 5% të të gjitha programeve të strehimit social (dispozita kalimtare) dhe i përcakton romët si grup prioritar në disa programe të strehimit social (subvencionimin e qirave, përmirësimin e kushteve të strehimit, grantet e menjëhershme për strehimin me kosto të ulët. Dispozitat e sipërpërmendura nuk kanë hyrë ende në fuqi për shkak se nuk janë miratuar ende aktet nënligjore në zbatim të tyre. Megjithatë, faktet tregojnë se familjet rome dhe egjiptiane kanë marrë trajtim prioritar nga programet e strehimit, madje edhe më shumë se 5% që përcaktohet në nenin 77 të Ligjit “Për strehimin social”. Disa nga nenet e Ligjit “Për strehimin social” mund të lejojnë urbanizimin dhe programet e rivitalizimit të vendbanimeve nëse kombinohet me dispozitat e Ligjit “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”. Duhet të hartohen akte nënligjore të përshtatshme për të lejuar programe strehimi të cilat do të kombinojnë legalizimin e banesave me sigurimin e banesave sociale (kur legalizimi nuk është i mundur), së bashku me punimet infrastrukturore dhe rikonfigurimin e vendbanimeve tradicionale në përputhje me standardet minimale të urbanistikës. Aspektet kryesore për zgjidhjen e çështjes së strehimit të romëve në Shqipëri janë si më poshtë: është më pak e kushtueshme të legalizohen njësitë ekzistuese të banimit dhe vendbanimet aktuale sesa të ndërtohen shtëpi të reja sociale; nevojitet Zhvillimi i programeve të integruara që kombinojnë punësimin dhe strehimin; legalizimi dhe legjislacioni i banesave sociale duhet të rregullohen për të lejuar programet e urbanizimit të vendbanimeve dhe për të rihapur procesin e legalizimit në mënyrë që të mund të zbatohen programe të tilla (duke kombinuar legalizimin me sigurimin e banesave sociale). Kjo mund të kërkojë trajtim specifik ligjor të banesave rome dhe vendbanimeve joformale të romëve, duke u përqendruar te përcaktimi i vendbanimeve të përshtatshme, afatet e reja të legalizimit, llojet e strehimit që mund ose nuk mund të legalizohen, si dhe strukturat përkatëse të strehimit social dhe mbështetjen shoqërore.

Projekti i Integrit të Romëve do të mbështesë Qeverinë e Shqipërisë për: zhvillimin e metodologjisë për priorizimin e romëve sipas dispozitave të Ligjit “Për strehimin social” bazuar në të dhënat e disponueshme; zhvillimin e metodologjisë së aksesit integral që kombinon punësimin dhe mbështetjen për strehim; dhe për zhvillimin e të paktën një propozimi financimi për rivitalizimin e vendbanimeve (nëse rihapet legalizimi) ose një programi të strehimit social. Projekti për integrimin e romëve do të mbështesë gjithashtu zhvillimin e metodologjisë për hartëzimin e banesave dhe hartëzimin e banesave në të paktën një vendbanim informal nëse kërkohet informacion shtesë për përgatitjen dhe zbatimin e një programi (banesash sociale ose legalizimi).

